



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:069549

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05659927

**P.nr..../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit E... B..... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 326 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1032/20 të datës 31.03.2022, duke vepruar sipas detyrës zyrtare me datë 07.05.2024 bie këtë:

**A K V E N D I M**

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP.II.nr.1032/20 të datës 31.03.2022.

**PUSHOHET** procedure penale ndaj të akuzuarit E... B....., i lindur me ....., në Pejë me vendbanim ne rr: M... B....., nr... nga i babai E., e nëna D....., e gjinisë S....., ka të kryer shkollën mesme, me profesion punëtor teknik, martuar dy fëmijë, me gjendje të mesme ekonomike, i identifikuar, në bazë të letërnjoftimit me nr. .... posedon telefon me nr. ...., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 326 par. 1 të KPRK-së

E dëmtuara K.... sh.a me seli në P... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

**A R S Y E T I M**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Përgjithshme fillimisht kishte ngritur aktakuzën PP.II.nr.1032/20 të datës 21.09.2020 ndaj të pandehurës Sh.... B..... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, ndërsa me datën ..... Prokuroria është tërhequr nga aktakuza ndaj të pandehurës Sh.... B.....

Me pas Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Përgjithshme ka ngritur aktakuzën e re me nr. të njëjtë PP.II.nr.1032/20 të datës 31.03.2020 ndaj të pandehurit E... B..... përkatësisht ndaj ish bashkëshortit të të pandehurës Sh..... B.... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka gjetur se në këtë çështje penale ka arritur afati i parashkrimit relativ i ndjekjes penale dhe atë me datë 14.07.2020 ndaj të akuzuarit E... B..... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës i pandehuri është akuzuar për veprën penale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së për të cilëve veprën është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri ne 3 vit, e për të cilën vepër penale sipas kodit penal 04-L-129 në bazë të të cilit është dashur të ngritet aktakuza afati relativ i ndjekjes penale ka arritur para se te ngritet aktakuza me datë 31.03.2022.

Prandaj sa i përket dënueshmeris kodi i ri 06/L-074 ka paraparë dënim me të mendë se sa kodi 04/L-129 që është dashur të aplikohet ne rastin konkret, e po ashtu sa i përket kohës së parashkrimit kodi 04/L-129 përkatësisht neni 106 afatet e parashkrimit të ndjekjes penale i ka përcaktuar me te shkurtra.

Prandaj gjykata sipas detyrës zyrtare ka aplikuar Kodin e aplikueshëm penale në kohen e kryerjes se veprës penale (14.07.2018) ngase me dispozitën ligjore të nenin 3 të KPRK-së është përcaktuar se ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë ne fuqi ne kohen e kryerje së veprës penale ( zbatimi i ligjit me të favorshëm).

Me dispozitën ligjore të nenit 359 të KPPRK-së është përcaktuar se: gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës.

Andaj gjykata ka vlerësuar se është i pa kontestueshëm fakti se aktakuza e Prokurorit të Shtetit PP.nr.1032/20 të datës 31.03.2022 është parashkruar me datë 14.07.2020, ndaj të pandehurit E... B..... , pasi kanë kaluar dy vite nga koha e kryerjes së veprës penale me datë 14.07.2018, e për të cilën është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në 1 vite sipas kodit të aplikueshëm ne kohen e kryerjes se veprës penale ( Kodi nr. 04/L-129).

Me depozitën ligjore të nenit 106 par.1 pika 1.6 të KPRK-së është paraparë se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 2 vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri ne një vitë burgim ose me gjobë. Ndërsa dispozita ligjore e nenit 107 par. 8 të KPRK-së ka përcaktuar se ndjekja penal ndalohet ne çdo rast kur te ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 KPP-së.

Prandaj nga arsyet e cekura me lartë gjykata ne kuptim te nenit të nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2022:069549, 07.05.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

---

**Edona Berisha Kastrati**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

---

**Musë Povataj**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 10 ditësh pas marrjes, gjykatës se Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj gjykate.